



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: [rmuca@klsb.org.al](mailto:rmuca@klsb.org.al); Web-site: [www.klsb.org.al](http://www.klsb.org.al)

### Auditim performance:

## "EFEKTIVITETI I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE DHE REDUKTIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE 2011-2015".

### Përmbledhje Ekzekutive

Në zbatim të planit vjetor 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas shkresës nr. 465, datë 30.04.2015, njoftim për fillim auditimi, ndërmori auditimin me temë "*Efektiviteti i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011-2015*".

Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimin Social Shtetëror, Policinë e Shtetit, Drejtoritë e Policisë së Qarqeve Tiranë, Korçë, dhe Berat, Ministrinë e Drejtësisë, Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, Ministrinë e Financave dhe në Bashkitë e Qarqeve Tiranë, Korçë, dhe Berat.

Pas përfundimit të punës paraprake audituese më datë 30.04.2015 u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr 465/1, datë 24.07.2015 iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjekteve të audituara. Raporti përfundimtar është hartuar pasi janë shqyrtuar shpjegimet e dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim.

Në përfundim, pasi Kryetari u njoh me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja "c" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit":

### K O N K L U D O I:

Standardet që përdorin vende të ndryshëm për ofrimin e shërbimeve për kategorinë e viktimave të dhunës në familje janë në varësi të nivelit ekonomik të zhvillimit të tyre. Këshilli i Evropës në një studim të bërë në vitin 2008<sup>1</sup> i cili ka përcaktuar standardet minimale që duhet

<sup>1</sup> <http://www.coe.int/equality>, Combating violence against women: minimum standards for support services

të plotësojë një vend anëtar për këtë kategori të popullsisë. Çështjet e barazisë gjinore janë në qendër të politikave sociale të vendeve të Bashkimit Evropian (BE) dhe një nga kërkesat për vendet që kanë hyrë në procesin e integritit evropian. Duke ditur qartë nivelin, shpeshtësinë si dhe koston sociale, dhuna me bazë gjinore mbetet një shqetësim i madh në Shqipëri, si një nga dhunimet më serioze dhe të vazhdueshme të të drejtave të njeriut në vend. Është e domosdoshme që qeveria të ndërmarrë iniciativat e duhura kundër këtij fenomeni në mënyrë që të respektojë dhe plotësojë të drejtat themelore të grave dhe fëmijëve si pjesë e të drejtave të njeriut. Pavarësisht nga iniciativat dhe aktivitetet e organizatave të ndryshme, veprimet e ndërmarra nga shteti kanë mundësinë të unifikojnë dhe të konsolidojnë këto përpjekje dhe pse jo t'i nxisin dhe promovojnë. Për këtë fenomen të shoqërisë tonë institucionet përgjegjëse kanë hartuar dhe implementuar një strategji kombëtare, me qëllim zvogëlimin e numrit të rasteve të dhunës në familje, mbështetjes së viktimave dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Megjithatë, auditimi SKBGJ-DHBGJDHF, shtojca 4, vazhdon të mos i përmbushi të gjitha objektivat e përcaktuara për periudhën 2011- 2015.

U evidentua një gabim material i strukturave të cilat kanë përgatitur VKM, nr. 334, dt. 17.02.2011, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij". Ky gabim tregon mungesë profesionalizmi dhe serioziteti. Ekziston vakum ligjor i cili nuk siguron mbrojtjen e nevojshme për viktimat DHF për periudhën e 48 orëve menjëherë pas referimit të rastit të dhunës.

Mungesa e përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Qarkut Tiranë në mbledhjet e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në komisariate ka bërë që bashkëpunimi ndërmjet këtyre strukturave të mos funksionojë duke sjellë pasoja në menaxhimin e rasteve të dhunës, pasoja të cilat i vuan viktimat e dhunës në familje.

Edhe pse arsimimi i personave që ofrojnë shërbime për viktimat e DHF është i përshtatshëm, mungesa e trajnimeve ndikon negativisht në arritjen e objektivave dhe mosrealizim të menaxhimit të rastit. Roli i psikologut është tejet i rëndësishëm pasi, ai bën vlerësimin e dinamikës së situatës familjare, realizon të ashtuquajturin bashkëbisedimin klinik dhe bën rekomandime për gjykatën

Cilësia e shërbimeve që ofrohen për viktimat e DHF dhe niveli i burimeve financiare të vëna në dispozicion vazhdon të mos i përmbushi standartet e nevojshme për të ofrimin e shërbimeve.

Prezenca me kohë të pjesshme e juristit dhe psikologut në QKTVDHF, bën që banorët e qendrës të mos marrin shërbimin dhe këshillimin e duhur juridik dhe psikologjik. Vetëm me dy ditë në javë këto punonjës nuk mund të përballojnë dot nevojat që ka qendra për përfaqësimin e viktimave në gjykatë dhe tratimin psikologjik në monentin e nevojshëm.

Nuk ekziston një numër jeshil kombëtar pa pagesë, i cili të shërbejë për denoncimin dhe/ose për ofrimin e këshillimit për viktimat e dhunës. Mungesa e numrit jeshil pa pagesë sjell pamundësinë për denoncimin e dhunës nga viktimat, si dhe të këshillimit për rrugën që duhet të ndjekin.

Bazuar në standardet minimale ndërkombëtare duhet që për çdo 10 000 banorë të ketë një shtrat, dhe referuar të dhënave për popullsinë të Instat, Shqipëria duhet të ketë 283 shtretër.

Në komisariatet e policisë së Tiranës dhe Beratit, ambientet ku priten viktimat e dhunës dhe plotësohet dokumentacioni për rastin e tyre janë të papërshtatshme. Shpesh për këtë qëllim

shfrytëzoheshin të njëjtat ambjent që përdroreshin për marrjen në pyetje të personave të ndaluar. Në Komisarriatin e Korçës si rezultat ndihmës së dhënë nga fondacioni Save the Children, është rikonstruktuar një ambient i cili përdoret nga institucioni si vend pritjeje për fëmijët dhe për viktimat e DHF.

Nuk është ndërmarrë asnjë iniciative për përmirësimin e legjislacionit të prokurimeve dhe financimeve publike për kontraktimin e shërbimeve të OJF-ve të specializuara për viktimat e DHF, parashikuar në SKBGJ-DHBGJDHF. Institucioni përgjegjës për realizimin e kësaj pike është MF.

Nisur nga konkluzionet mesipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij sektori Kryetari i KLSH-së, me Vendimin Nr. 185 datë 31.12.2015:

## V E N D O S I:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Mbi Efektivitetin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje”, të ushtruar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimin Social Shtetëror, Policinë e Shtetit, Drejtoritë e Policisë së Qarqeve Tiranë, Korçë, dhe Berat, Ministrinë e Drejtësisë, Komisionin Shtetëror për Ndhimën Juridike, Ministrinë e Financave dhe në Bashkitë e Qarqeve Tiranë, Korçë, dhe Berat.

II. Të miratojë rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

I. **Për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë:**

- ✓ MMSR të marrë masa urgjente për korigjimin e gabimit material në VKM nr. 334, dt. 17.02.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, konkretisht ndryshimin e bazës ligjore për nxjerrjen e aktit.

***Menjëherë***

- ✓ Të ngrihet një grup pune me përfaqësues të MMSR, MD, MF dhe DPSH me qëllim rregullimin ligjor për zgjidhjen e situatës së rasteve për periudhën nga momenti i denoncimit deri në lëshimin e UMM kur viktimat e DHF nuk ka ku të strehohet. Grupi i auditimit sugjeron tri mundësi zgjidhjeje por mund të ketë edhe më shumë;
  - MMSR të ndryshoj Nenin 18, pika 1 të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, për të shkurtuar afatin kohor të 48 orëve të lëshimit të UMM, ose;
  - DPSH të ndryshoj Nenin 109, pika 2 të Ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, duke shtuar “Për rastet kur personat shoqërohen për veprën e dhunës në familje shoqërimi duhet të zgjas deri në shprehjen e gjykatës në lidhjen me UMM, ose;
  - Në komisarriate të krijohen hapësira të përshtatshme për qëndrimin e viktimave të DHF deri në lëshimin e UMM.

***Deri në 30.06.2016***

- ✓ MMSR, të organizojë në mënyrë sistematike trajnime të përbashkëta me punonjës të

institucioneve të ndryshme që merren me DHF (policia, bashkia, gjykata, prokuroria, zyra e përmbarimit, shkollat, qendra shëndetësore, media, OJF).

*Në vazhdimësi*

- ✓ MMSR në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të marrin masa të menjëhershme për vendosjen e numrit jeshil kombëtar pa pagesë.

*Menjëherë*

- ✓ MMSR të kontraktojë OJF të cilat kanë kapacitetin të ofrojnë shërbime për rehabilitimin shkaktarëve të DHF.

*Në vazhdimësi*

## II. ***Për Shërbimin Social Shtetëror***

- ✓ SHSSH në bashkëpunim me QKTVDHF të hartojnë menjëherë planin vjetor të trainimit të personelit me qëllim sigurimin e shërbime me cilësi të lartë.

*Menjëherë*

- ✓ SHSSH, të marrë masa që në të ardhmen të mos rekrutojë persona, arsimimi i të cilëve nuk është në përputhje me përshkrimin e punës së pozicioneve në QKTVDHF.

*Në vazhdimësi*

- ✓ SHSSH të parashikojë rritjen e fondeve buxhetore për QKTVDHF.

*Deri më 30.06.2016*

- ✓ SHSSH të shtoj në organikën e QKTVDHF minimalisht një psikolog dhe një jurist me kohë të plotë.

*Deri më 30.06.2016*

## III. ***Për Drejtorinë e Policisë Shtetit:***

- ✓ Të ngrihet një grup pune me përfaqësues të MMSR, MD, MF dhe DPSH me qëllim rregullimin ligjor për zgjidhjen e situatës së rasteve për periudhën nga momenti i denoncimit deri në lëshimin e UMM kur viktima e DHF nuk ka ku të strehohet. Grupi i auditimit sugjeron tri mundësi zgjidhjeje por mund të ketë edhe më shumë;
  - MMSR të ndryshoj Nenin 18, pika 1 të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, për të shkurtuar afatin kohor të 48 orëve të lëshimit të UMM, ose;
  - DPSH të ndryshoj Nenin 109, pika 2 të Ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, duke shtuar “Për rastet kur personat shoqërohen për veprën e dhunës në familje shoqërimi duhet të zgjas deri në shprehjen e gjykatës në lidhjen me UMM, ose;
  - Në komisariate të krijohen hapësira të përshtatshme për qëndrimin e viktimave të DHF deri në lëshimin e UMM.

*Deri më 30.06.2016*

- ✓ DPQ-TR të siguroj pjesëmarrjen e personit përgjegjës të zyrës për të miturit dhe DHF në takimet e ETN.

*Menjëherë*

- ✓ Të organizohen trajnime për personat që mbajnë pozicionin e psikologut në DPQ-TR, DPQ-KO dhe DPQ-BR.

*Menjëherë*

- ✓ DPSH të marrë masa të menjëhershme për të realizuar trajnime të vazhdueshme me punonjësit e komisariateve të cilët përballen direkt me viktimat e DHF.

*Menjëherë*

- ✓ DPSH të shtojë në strukturën e komisariateve pozicionin e specialistit psikolog dhe të specialistit që do të trajtojë çështjet e DHF në nivel komisariati.

*Deri më 30.06.2016*

- ✓ DPSH të marrë masat e nevojshme për të krijuar ambiente të përshtatshme për pritjen e viktimave të DHF.

*Menjëherë*

#### IV. *Për Ministrinë e Drejtësisë:*

- ✓ Të ngrihet një grup pune me përfaqësues të MMSR, MD, MF dhe DPSH me qëllim rregullimin ligjor për zgjidhjen e situatës së rasteve për periudhën nga momenti i denoncimit deri në lëshimin e UMM kur viktimat e DHF nuk ka ku të strehohet. Grupi i auditimit sugjeron tri mundësi zgjidhjeje por mund të ketë edhe më shumë;
  - MMSR të ndryshoj Nenin 18, pika 1 të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, për të shkurtuar afatin kohor të 48 orëve të lëshimit të UMM, ose;
  - DPSH të ndryshoj Nenin 109, pika 2 të Ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, duke shtuar “Për rastet kur personat shoqërohen për veprën e dhunës në familje shoqërimi duhet të zgjas deri në shprehjen e gjykatës në lidhjen me UMM, ose;
  - Në komisariate të krijohen hapësira të përshtatshme për qëndrimin e viktimave të DHF deri në lëshimin e UMM.

*Deri më 30.06.2016*

- ✓ MD dhe KSHNJ të rrisin fondet buxhetore duke pasur parasysh statistikën që disponon MD për DHF.

*Deri më 30.06.2016*

#### V. *Për Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike:*

- ✓ MD dhe KSHNJ të rrisin fondet buxhetore duke pasur parasysh statistikën që disponon MD për DHF.

*Deri më 30.06.2016*

- ✓ KSHNJ të krijojë regjistrin e përfituesve të ndihmës juridike falas bazuar në kategorinë e përfituesve.

*Menjëherë*

- ✓ KSHNJ të bëjë kategorizimin e fondeve buxhetore sipas kërkesës së ligjit.

*Menjëherë*

- ✓ KSHNJ të krijojë faqen e internetit ku përveç aktivitetit të saj në zbatim të Ligjit 1039 datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, Kreu IV, Neni 20. Pika 3 të publikoj listën e avokatëve që autorizohen për ofrimin e ndihmës juridike falas.

*Deri më 30.06.2016*

- ✓ KSHNJ të lidhë marrëveshje me dhomat e avokatisë mbi bazë qarku, ti bëjë prezente këto marrëveshje tek koordinatori i DHF i cili në momentet e plotësimit të dokumentacionit të viktimës të plotësoj dhe kërkesën për ndihmë juridike falas.

*Deri më 30.06.2016*

- ✓ KSHNJ të rrisë numrin e kontratave të lidhura me avokatët apo dhomat e avokatisë dhe OJF me qëllim përballimin e nevojave të viktimave të DHF, përfitues të ndihmës juridike.

*Menjëherë*

#### VI. *Për Ministrinë e Financave:*

- ✓ Të ngrihet një grup pune me përfaqësues të MMSR, MD, MF dhe DPSH me qëllim rregullimin ligjor për zgjidhjen e situatës së rasteve për periudhën nga momenti i denoncimit deri në lëshimin e UMM kur viktimat e DHF nuk ka ku të strehohet. Grupi i auditimit sugjeron tri mundësi zgjidhjeje por mund të ketë edhe më shumë;
  - MMSR të ndryshoj Nenin 18, pika 1 të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, për të shkurtuar afatin kohor të 48 orëve të lëshimit të UMM, ose;
  - DPSH të ndryshoj Nenin 109, pika 2 të Ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, duke shtuar “Për rastet kur personat shoqërohen për veprën e dhunës në familje shoqërimi duhet të zgjas deri në shprehjen e gjykatës në lidhjen me UMM, ose;
  - Në komisariate të krijohen hapësira të përshtatshme për qëndrimin e viktimave të DHF deri në lëshimin e UMM.

*Deri më 30.06.2016*

- ✓ MF të përmbushë objektivin e SKBGJ-DHBGJDHF, shtojca 4, objektivi specifik 3, pika 3 “Përmirësimin e legjislacionit të prokurimeve dhe financimeve publike për të lejuar kontraktimin e shërbimeve OJF-ve të specializuara”.

*Deri më 30.06.2016*

- ✓ MF të parashikoj një procedurë të veçantë për shërbimet sociale në legjislacionin e prokurimeve publike që vlerëson ekspertizën, eksperiencën dhe cilësinë e shërbimit bazuar në standardet sociale në raport ndaj çmimit më të ulët, në përputhje me VKM nr. 80 dt. 28.01.2008 për strategjinë sektoriale të shërbimeve sociale.

*Deri më 30.06.2016*

VII. **Për Prokurorinë e Përgjithëshme:**

- ✓ Prokuroritë e rretheve gjyqësore TR, BR, KO të sigurojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesit të tyre në mbledhjet e ETN.

*Menjëherë*

VIII. **Për Bashkinë Berat:**

- ✓ Kryetari i Bashkisë Berat të mbledhë KD, të miratojë marrëveshjen e bashkëpunimit, dhe të zbatoj detyrimet ligjore që rrjedhin nga VKM Nr.334 datë 17.02.2011.

*Menjëherë*

Grupi i auditimit

Artur Hasanbelliu

Melina Kabo

Blerina Kërçuku

Drejtori

Rinald Muça

Tiranë, Dhjetor 2015